


RREGULLAT E KONKURSIONIT

FITO NJË ÇATI*

*Tjegulla BMI



Konkursi, "**Fito një çati**" (në vijim referuar si "**Konkursi**") organizohet në përputhje me dispozitat e Kodit Civil, Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar (në vijim referuar si "**Ligji për të dhënat personale**"). Konkursi organizohet nga Bramac Sisteme për çati Sh.p.k, me seli ligjore në adresën: Rr. Ismail Qemali, Pallati 12 katësh (i ri), Kati III, Zyra 6, Tiranë, me NIPT K81720007N (në vijim referuar si "**Organizatori**").

1. Para se të regjistroheshi në këtë Konkurs dhe të fitoni statusin e Konkurrentit, ju lutemi njihuni me rregullat e pasqyruara në këtë Rregullore (në vijim referuar si "**Rregullat**"). Duke marrë pjesë në Konkurs në përputhje me nenin 5 të Rregullave, ju konfirmoni se i keni lexuar Rregullat dhe se i pranoni dhe jeni dakord me to.
2. Pjesëmarrës në Konkurs mund të jenë vetëm personat mbi moshën 18 vjeç, me vendbanim në Republikën e Shqipërisë.
3. Nuk mund të marrin pjesë në Konkurs personat e përfshirë në organizimin, marketingun dhe zhvillimin e Konkursit, si dhe paraardhësit, pasardhësit dhe bashkëshortët e Organizatorit.
4. Konkursi do të fillojë më datë **01.07.2021**, në orën **12:00** dhe do të përfundojë më datë **01.09.2021** në orën **12:00** dhe organizohet për qëllim marketingu dhe promovimin e shitjeve të produkteve të tij.
5. Në mënyrë që një person, i cili plotëson kushtet e përcaktuara në këto Rregulla, të kualifikohet për një çmim të mundshëm, duhet të dërgojë në faqen e internetit <https://al.bmigroup.com/fito-nje-cati/> ose në kutinë e mesazheve në profilin e Organizatorit në Facebook / Instagram, një fotografi të vendndodhjes së çatisë së tij/saj të ardhshme me një histori të shkurtër se si e imagjinon shtëpinë e tij/saj të ardhshme ("çatinë mbi kokë" - domethënë ambienti në të cilin ai/ajo do të dojë të jetojë) dhe të japë një adresë email-i ose numër telefoni për të marrë statusin e Konkurrentit në Konkurs. Fotografitë mund të jenë të tilla si: fotografi të çatave të vjetra që kanë nevojë për restaurim si edhe fotografi të ndërtesave të papërfunduara pa çati. Fotografia duhet të jetë me kënd të gjerë, domethënë të përmbajë sa më shumë elementë/hapësira që të jetë e mundur.
6. **KUJDES!** Fotografitë duhet të jenë të bëra nga Konkurrenti. Në rast se vihet re se një ose disa fotografi të Konkurrentit janë marrë nga interneti, ose nga ndonjë burim tjetër, pa patur autorizimin ose të drejtat e përdorimit të saj ose nëse për një ose disa fotografi ngrihen pretendime nga palë të treta

pranë Organizatorit, atëherë fotografia ose fotografitë nuk do të publikohen dhe si rrjedhojë Konkurenti do të skualifikohet automatikisht nga Konkursi.

7. Fotografitë nuk duhet të përmbajnë pamje të papërshtatshme të cilat nxisin dhunën, përdorimin e armëve, që kanë përmbajtje moralisht të papërshtatshme, të përmbajnë propagandë politike, të nxisin diskriminim etnik, racor dhe fetar si dhe çdo përmbajtje tjetër diskriminuese të ndaluar me ligj ashtu si dhe të favorizojnë përdorimin e substancave psikotrope dhe narkotike, duhanit, alkoolit etj.
8. Konkurenti, i cili paraqet një fotografi dhe një histori, bie dakord që Organizatori mund të përdorë falas në faqen e internetit, dhe në profilet Facebook, Instagram e LinkedIn këtë histori apo këtë fotografi për promovimin e produkteve dhe shërbimeve, pa asnjë kufizim në kohë, hapësirë apo kufizime tematike
9. **Pjesëmarrësi në "Konkurs", në përputhje me pikën 5 të këtyre rregullave, bie dakord që Organizatori të përpunojë të dhënat e tij/saj personale për qëllimet e "Konkursit", në përputhje me këto rregulla.**
10. Përzgjedhja e fituesve:

- **Përzgjedhja e 5 finalistëve:** Anëtarët e jurisë (Laert Huta, Alma Šatara, Katarina Marunić), sipas gjykimit të tyre, do të zgjedhin, nga të gjitha aplikimet e pranuar që plotësojnë kërkesat e këtyre rregullave, 5 aplikime (finalistë), dhe më datë 15.09.2021 do t'i shpallin finalistët në faqen e internetit dhe në profilin e Organizatorit në Facebook, Instagram dhe LinkedIn.

- **Përzgjedhja e fituesve të çmimit të parë, të dytë dhe të tretë** do të bëhet me votimin publik të të gjitha palëve të interesuara, duke pëlqyer aplikimet / postimet e 5 finalistëve në profilin e Organizatorit në Facebook, Instagram dhe LinkedIn në periudhën kohore nga **15.09.2021** ora **17:00** deri më **30.09.2021** ora **17:00**. Aplikimi / postimi me më shumë pëlqime është fituesi i çmimit të parë, aplikimi / postimi me numrin e pëlqimeve në vendin e dytë fiton çmimin e dytë, aplikimi / postimi me numrin e pëlqimeve në vendin e tretë fiton çmimin e tretë. Anëtarët e jurisë do të monitorojnë të gjithë procesin e votimit publik dhe më datë **01.10.2021** do të shpallin fituesit në faqen e internetit dhe në profilin e Organizatorit në Facebook, Instagram e LinkedIn.

Fituesi i çmimit të parë do të përfitojë 100 m² çati (tjegulla të plota dhe tjegulla aksesore) - tjegulla betoni, modeli Natura. Çmimi i dytë është një kupon për një zbritje prej 20% në tjegulla betoni, modeli Natura (tjegulla të plota dhe tjegulla aksesore për 100 m² çati). Çmimi i tretë është një kupon për një zbritje prej 10% në tjegulla betoni, modeli Natura (tjegulla të plota dhe tjegulla aksesore për 100 m²). I njëjti person mund të fitojë vetëm një çmim. Çmimet nuk mund të transferohen tek palë të treta dhe nuk mund të këmbehen kundrejt parave në dorë. Për të marrë çmimin, organizatori do të kontaktojë fituesit brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e rezultateve, në adresën e email-it ose numrin e telefonit të dhënë gjatë aplikimit për "Konkursin" dhe do t'i informojë në lidhje me çmimin e fituar.

11. Organizatori rezervon të drejtën të mos japë çmimin nëse shpërblimi nuk mund t'i dorëzohet fituesit në përputhje me marrëveshjen për mënyrën e dorëzimit të shpërblimit ose nëse dorëzimi i shpërblimit refuzohet nga Fituesi.
12. Në rastin kur Organizatori dyshon se Pjesëmarrësit në Konkurs nuk konkurrojnë në përputhje me Rregullat e pasqyruara në këtë Rregullore, do të skualifikohen, pa njoftim dhe shpjegim paraprak.

Mbrojtja e të dhënave personale

Të gjitha të dhënat personale që merren nga Pjesëmarrësit në Konkurs do të mbrohen, mbahen dhe përpunohen në përputhje me këto Rregulla dhe me Ligjin për të dhënat personale.

1. Për qëllime të pjesëmarrjes në konkursin e çmimeve, Organizatori do të mbledhë dhe përpunojë të dhënat e mëposhtme personale të pjesëmarrësve në Konkurs:
 - (a) Numrin e telefonit;
 - (b) Adresën e postës elektronike;
2. Përveç të dhënave të sipërpërmendura, brenda kontekstit të organizimit të Konkursit, si edhe për dorëzimin e çmimit, Fituesit të Konkursit mund t'i kërkohet emri, mbiemri si dhe adresa e banimit.
3. Organizatori deklaron se nuk transmeton, shet, ose në asnjë mënyrë nuk siguron të dhëna personale për të tretë, përfshirë edhe operatorë të tjerë ekonomikë.
4. Të dhënat personale të marra do të përpunohen kryesisht për qëllimin e realizimit të Konkursit
5. Pjesëmarrësit në Konkurs do të autorizojnë shprehimisht Organizatorin duke dhënë pëlqimin për ruajtjen dhe përpunimin e të dhënave të tyre personale.
6. Të dhënat personale të marra do të ruhen deri në momentin e shpalljes së fituesit të Konkursit, domethënë deri në momentin kur çmimi i dorëzohet Fituesit. Pas dorëzimit të çmimit tek Fituesi, të dhënat personale të pjesëmarrësve në konkurs do të fshihen nga baza e të dhënave të Organizatorit, si dhe nga çdo rrjet social në përdorim të këtij të fundit.
7. Personat prej të cilëve janë mbledhur të dhënat personale gëzojnë të drejtën të aksesojnë në çdo kohë të dhënat e tyre personale. Gjithashtu, ata gëzojnë të drejtën të kërkojnë bllokimin, korrigjimin ose fshirjen e të dhënave përkatëse pa pagesë. Organizatori, brenda 30 ditëve nga data e marrjes së kërkesës nga Pjesëmarrësi në Konkurs, pra nga subjekti i të dhënave, duhet ta informojë për përpunimin e ligjshëm të të dhënave, kryerjen ose moskryerjen e bllokimit, korrigjimit apo të fshirjes. Në rast se Organizatori nuk bën bllokimin, korrigjimin ose fshirjen e të dhënave të kërkuara prej tij, Pjesëmarrësi në Konkurs gëzon të drejtën e ankimit sipas ligjit.
8. Personat nga të cilët mblidhen të dhënat personale gëzojnë të drejtën të revokojnë pëlqimin e dhënë prej tyre në çdo kohë. Revokimi i pëlqimit e bën të paligjshëm përpunimin e mëtejshëm të të dhënave. Revokimi i pëlqimit krijon pasoja që prej datës së ushtrimit të së drejtës së revokimit.
9. Organizatori garanton se gjatë përpunimit të të dhënave personale të mbledhura, do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të garantuar përdorimin e ligjshëm dhe të sigurt të të dhënave, në përputhje me nenin 20 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar.
10. Të dhënat e Organizatorit:

Emri: Bramac Sisteme për çati Sh.p.k ;

Adresa e selisë ligjore: Rr. Ismail Qemali, Pallati 12 katësh (i ri), Kati III, Zyra 6, Tiranë;

Adresa për pranimin e postës elektronike: info_al@bmigroup.com;

Numri i telefonit: +355 4 222 6397